



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATES –Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Projekt ‘Ura e Fushes se Fshatit Brataj’”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 22114311-5
Projekte

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,801,175 (Nje milion e tetëqind e nje mijë e njeqind shtatëdhjet e pese) Lekë **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor **Bashkia Selenice**, ne zbatim të VKM nr 354, datë 11.05.2016, “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorri, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, Bazuar në projekt – preventivin paraprak, ku vlera paraprake e preventivit është 53,031,872.00 Leke pa tvsh, grupi tarifar III, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentim: Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose:

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*

ii. *Formular Vlerësimi*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*

ii. *Formular Vlerësimi*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.1.2 **Licensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

6 – PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

6.a) - Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

7 – PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

7.b) - Ura dhe vepra arti mbi 10 m.

7.c) - Ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sisteme të pacaktuara statikisht dhe sisteme të tjera speciale.

8 – PROJEKTUES GJEODET

- 8.a) - Rilevime inxhinierike.
- 8.c) - Sisteme GIS.
- 8.d) - Bazamente gjeodezike.
- 8.e) - Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

9 – STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- 9.d) - Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- 9.e) - Studime e projekte hidrogjeologjike.

12 – STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/persona juridikë).

- 12.a) - Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- 12.b) - Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.
- 12.) c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.
- 12.f) - Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonime sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Licensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës,

të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mesipërme janë vendosur në kuader të natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare **2022, 2023** dhe **2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Kopje të çertifikuar të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit **2022, 2023** dhe **2024**, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit . Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, e ndryshuar, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilanci të njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim:Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: “Personat juridikë

që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 dhe kesten e maturuar për vitin 2025, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, në LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR" i ndryshuar. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Selenicë**, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika e mwsipwrme është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kështesave të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik në Licensën e Shoqërisë stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Strukturist
- 1 (një) Inxhinier gjeolog

- 1 (një) Inxhinier gjeodet
- 1(nje) Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te pergjithshme te references per objektet pjese e kesaj procedure, pjese e secilave do te jene te licensuar per sherbimet qe priten te realizohen.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik per afatin e kerkuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryejë sherbimin ne kohe dhe cilesi.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **5 (pese) punonjës** për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar

b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per per periudhën e fundit të deklaruar.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është nje prove bindese per AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të

operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë se shërbimet që kërkohej të kryhen. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme).
- Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001-2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme).
- Certifikat e menaxhimit dhe Sigurisë në Pune ISO 45001:2018 ose **ekuivalente** (e vlefshme).
- Certifikat e menaxhimit të energjisë ISO 45001:2018 ose **ekuivalente** (e vlefshme).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit , sigurisë në punë, janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit, sigurisë në punë,

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1(një) Pajisje GPS

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje të noterizuar) si dhe skedën teknike.

- 1(një) Pajisje Total Station

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje të noterizuar) si dhe skedën teknike.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mesiperme janë vendosur në përputhje me natyrën e

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mesipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike/preventivi/dokumentacioni i nevojshëm, janë vendosur në bazë të buxhetit dhe VKB, si dhe projekt idese të hartuar nga drejtoria e projekteve si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe në përputhje me nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Personi Përgjegjes:

Specialist fushe:

Fondin Limit: